



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 145

Tiranë – E premte, 17 shtator 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 68/2021, datë 17.9.2021	Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave.....	13831
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.506, datë 17.9.2021	Për lirimimin nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.....	13850



VENDIM
Nr. 68/2021

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES DHE PROGRAMIT POLITIK
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të neneve 95, 96, 97, 98 dhe 78 të Kushtetutës, të nenit 110 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 13 213, datë 14.9.2021, “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet përbërja e Këshillit të Ministrave, si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------|---|
| 1. Zoti Edi Rama | Kryeministër |
| 2. Zoti Arben Ahmetaj | Zëvendëskryeministër dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave |
| 3. Zonja Olta Xhaçka | Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| 4. Zoti Niko Peleshi | Ministër i Mbrojtjes |
| 5. Zoti Bledar Çuçi | Ministër i Brendshëm |
| 6. Zonja Delina Ibrahimaj | Ministër i Financave dhe Ekonomisë |
| 7. Zonja Belinda Balluku | Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë |
| 8. Zonja Evis Kushi | Ministër i Arsimit dhe Sportit |
| 9. Zoti Ulsi Manja | Ministër i Drejtësisë |
| 10. Zonja Elva Margariti | Ministër i Kulturës |
| 11. Zonja Frida Krifca | Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| 12. Zonja Ogerta Manastirliu | Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| 13. Zonja Mirela Kumbaro Furxhi | Ministër i Turizmit dhe Mjedisit |
| 14. Zonja Elisa Spiropali | Ministër Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin |
| 15. Zonja Edona Bilali | Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes |
| 16. Zonja Bora Muzhaqi | Ministër Shteti për Rininë dhe Fëmijët |
| 17. Zonja Milva Ekonomi | Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve |

II. Miratohet programi politik i Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datën 17.9.2021



KËSHILLI I MINISTRAVE PROGRAMI QEVERISËS

Tabela e të dhënave

MANDATI I TRETË – PROGRAMI YNË
RIMËKËMBJA
MIRËQENIE PËR TË GJITHË
MODERNIZIM PËR ZHVILLIM
FAMILJA
SHQIPËRIA E FORTË
RIMËKËMBJA
RINDËRTIMI
LUFTA ME PANDEMINË COVID-19
NJË STRATEGJI E RE PËR SHËNDETIN
DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM
MIRËQENIE PËR TË GJITHË
TAKSA E NDERSHME PROGRESIVE
RRITJA E PAGAVE
BIZNESI I VOGËL DHE FAMILJA PRO-
DUKTIVE
ZHVILLIMI I BUJQËSISË DHE I FSHATIT
MODERNIZIM PËR ZHVILLIM
BIZNESI I MANIFAKTURËS, TEKNOLO-
GJISË SË INFORMACIONIT DHE SHËRBI-
MEVE
INFRASTRUKTURA
TRANSPORTI AJROR, RRUGOR, HEKU-
RUDHOR DHE DETAR
ENERGJIA
TURIZMI DHE MJEDISI
KULTURA
SHOQËRIA DIGJITALE
FAMILJA
STREHIMI
FËMIJËT
ARSIMI
KUJDESI PËR TË MOSHUARIT DHE
QYTETARËT MË NË NEVOJË
SHQIPËRIA E SHËNDETSHME
SHQIPËRIA E FORTË
SHQIPËRIA E SË DREJTËS
SIGURIA E PRONËS
KONSOLIDOJMË IMAZHIN DHE ROLIN
E SHQIPËRISË
MBROJMË INTERESAT E GJITHË
SHQIPTARËVE
INTEGRIMI EVROPIAN
SHQIPËRIA E SIGURT

MANDATI I TRETË – PROGRAMI YNË

Qeverisja nuk është zanat por mandat i deleguar nga populli për ta ngitur vendin më lartë në shkallën e zhvillimit.

Mandati i tretë i kësaj mazhorance është historik dhe vendimtar për Shqipërinë e dekadës që sapo ka filluar dhe sidomos për hapat që do të shoqërojnë të ardhmen e fëmijëve tanë.

Kjo është arsyeja pse programi qeverisës është konceptuar si një plan i kujdesshëm dhe i detajuar reformash dhe aksionesh, që synon të materializojë në çdo qelizë të qeverisjes vizionin “Shqipëria 2030”, një projekt madhor që mishëron ambicien tonë për ta çuar Shqipërinë në nivelin tjetër të zhvillimit.

Pas dy mandateve sfiduese për qeverisjen socialiste, pas mandatit të parë gjatë të cilit u jetësuan reformat më të vështira, por të domosdoshme për vendin, dhe pas mandatit të dytë, ku përballuam me sukses dy fatkeqësi të njëpasnjëshme, si tërmeti dhe pandemia, sot kemi themele të forta mbi të cilat do të ndërtojmë Shqipërinë 2030, një shtet evropian, që vendos një tjetër standard të qeverisjes në shërbim të qytetarëve shqiptarë.

Mandati i tretë organikusht nis me objektiva të qartë për mënyrën si do të ndërtojmë, hap pas hapi, të ardhmen tonë evropiane, duke u mbështetur së pari në 5 shtylla kryesore:

1. Rimëkëmbje e ekonomisë nga tërmeti dhe nga pandemia;

2. Mirëqenie për të gjithë, që do të përkthehet në një ekonomi të zhvilluar që krijon shanse për të gjithë;

3. Modernizim për zhvillim të ekonomisë prodhuese, turizmit, energjisë, bujqësisë, ekonomisë digjitale, transporteve dhe shërbimeve;

4. Familja, si themeli ku ndërtojmë të ardhmen;

5. Shqipëri e fortë, me shtet të fortë, vëmendje për çdo shqiptar dhe me dinjitet në botë.

RIMËKËMBJA

Ringrihemi më të fortë pas dy goditjeve të njëpasnjëshme të tërmetit dhe të pandemisë

Nuk mund të nisë ky mandat pa përgjegjësinë e ringritjes pas fatkeqësive. Shqipëria u godit nga dy fatkeqësi të njëpasnjëshme, tërmeti dhe pandemia, por ne ia dolëm të ringrihemi brenda një viti, falë solidaritetit, qytetarisë dhe shtetit në lartësinë e detyrës, për të mos lënë askënd vetëm. U ringritëm



edhe falë reformave të ndërmarra në mandatin e parë, të cilat e shpëtuan vendin nga situata katastrofike ku e gjetëm në vitin 2013, e pa të cilat do të kishte qenë në kufijtë e së pamundurës të fitonim betejën me dy fronte kundër tërmetit e pandemisë.

Fatkeqësitë natyrore nuk i parandalojmë dot, por mënyra si reagojmë ndaj tyre, si u përgjigjemi qytetarëve në ditë të vështira dhe si i paraprijmë në kohë normale përballjes me to, tregon shumë për familjen tonë politike, për përgjegjësinë tonë kombëtare, si dhe vullnetin e padiskutueshëm për të bërë shtet.

Ruajtja e jetëve të bashkëqytetarëve tanë është detyrimi ynë themelor, ndaj morëm përsipër të luftojmë me çdo mjet pandeminë. Ndërmorëm, ndër të parët, rrugën e vështirë të mbylljes dhe hartuam një plan të qartë për menaxhimin e **pandemisë**, mbajtjen nën kontroll të përhapjes së virusit dhe shërimin brenda kushteve tejte të vështira.

Siguroam vaksinën dhe filluam procesin e vaksinimit. Çdo qytetar shqiptar do të ketë mundësinë të vaksinohet deri në pranverën e vitit 2022.

Rindërtimi është një program unik, tërësisht social dhe zhvillimor, me në qendër qytetarët. Si asnjë vend tjetër më parë, morëm përsipër të rindërtojmë çdo shtëpi të shkatërruar nga tërmeti. Të gjitha familjet që mbetën pa shtëpi do të marrin një të re, më të mirë, më të fortë, më të bukur dhe, mbi të gjitha, falas, të dhuruar nga shteti, që t'ua trashëgojnë brezave, ta shesin dhe ta gëzojnë me të drejta të plota.

Garantuam burimet e nevojshme financiare për të vënë në jetë procesin e rindërtimit. Konferenca e Donatorëve, më 17 shkurt 2020, ishte jo vetëm shprehje prekëse e solidaritetit njerëzor të miqve të Shqipërisë, por edhe shprehje e drejtpërdrejtë e besimit të partnerëve ndërkombëtarë te qeveria shqiptare.

Rindërtimi vazhdon çdo ditë, me një shtëpi të re, një shkollë të re, një lagje të re. Sot të gjitha zonat e prekura nga tërmeti janë në kantier, e në shumë prej tyre po ngrihen nga themelet godinat dhe po rilindin lagjet e reja për mbi 42 mijë familje.

Tanimë kemi marrë shenjat e para të shërimit ekonomik, i cili falë vizionit e punës sonë do të jetë i plotë brenda 2022-it. Rimëkëmbja po jep shenjat e para të prekshme. Rritja ekonomike e tremujorit të

parë arriti në 5.5% dhe të gjitha të dhënat ekonomike tregojnë që tremujori i dytë do të jetë rekord. Shifrat e punësimit tregojnë një rritje të konsiderueshme e të prekshme të punësimit, me ulje të nivelit të papunësisë në 11.6%.

MIRËQENIE PËR TË GJITHË

Zhvillim ekonomik nga i cili përfiton çdo shqiptar

Qeveria e maxhorancës socialiste të mandatit të tretë beson te një shoqëri që ofron mundësi të barabarta dhe te një shtet që kujdeset në mënyrë të barabartë e të drejtë për të gjithë qytetarët e tij.

Ne besojmë që shoqëria jonë ka detyrimin të kujdeset për më të varfrit dhe ata që mundësitë i kanë më të pakta dhe ndihen të përjashtuar, ndaj mbetemi të angazhuar në parimin që ata që fitojnë më pak, paguajnë më pak dhe ata që fitojnë më shumë, paguajnë më shumë.

Taksa e ndershme progresive do të mbetet një kolonë themelore e programit tonë qeverisës për të garantuar mirëqenie për të gjithë.

Ne besojmë se Shqipëria është dhe do të vijojë të jetë edhe më e mirë nga puna e përkushtuar e vetëmohuese e mijëra **shërbëtorëve publikë**, mjekëve, infermierëve, zjarrfikësve, mësuesve, edukatorëve, inxhinierëve, punonjësve të rendit etj., të cilët këto dy vjet të fatkeqësive, më shumë se kurdoherë tjetër treguan me forcën e shembullit, se solidariteti dhe atdhedashuria janë arteria e padukshme që mban bashkë shoqërinë tonë. Jemi të angazhuar të sigurojmë kushte dinjitoze pune dhe shpërblim të merituar për sakrificat e gjithsecilit prej tyre.

Ne besojmë tek **të rinjtë** e këtij vendi, si forca që do të përshpejtojë progresin drejt Shqipërisë së gjeneratës tjetër, ndaj jemi të angazhuar t'u sigurojmë jo vetëm mundësi më të mira arsimimi në fushat prioritare, si: shkencat natyrore, teknologji e informacionit dhe inxhinieri, por mundësi reale për të qenë sipërmarrësit e ardhshëm në fushat e inovacionit e të teknologjisë, për të konkurruar denjësisht në tregun global.

Rilindja urbane ishte fillimi i një transformimi rrënjësor, që përgjatë tetë vjetëve preku thuajse të gjitha qendrat urbane në vend. Sot, qendrat e qyteteve kanë rilindur falë investimeve më të mëdha në 30 vjet, e bashkë me to edhe ekonomia, punësimi, turizmi, vlera e pronës dhe sipërmarrjet e reja lokale.



Vlora, Shkodra, Korça, Berati e Gjirokastra, si dhe dhjetëra qytete, kanë rilindur si qendra urbane e sociale dinjitoze e janë rikthyer në gurë të çmuar të kolanës së qytetërimit shqiptar.

Tirana, çdo ditë e më shumë, po bëhet jo vetëm kryeqendra e Shqiptarisë, por një pikë reference në rajon, e një metropol evropian.

Plani ynë i punës do të vijojë të shtrihet te rilindja e fshatit, punë e filluar në mandatin e dytë. Ne kemi detyrën, që, përmes rilindjes rurale t'i japim një hov të ri zhvillimit në fshat, duke investuar më shumë në infrastrukturë, shërbime shëndetësore e arsimore, ujësjellës-kanalizime, transferim njohurish dhe inovacion në drejtim të agropërpunimit, turizmit dhe mjedisit.

MODERNIZIM PËR ZHVILLIM

Një ekonomi të fortë bazuar në modernizim, produktivitet dhe konkurrueshmëri

Përgjatë dy mandateve të para, kjo qeveri tregoi që mund sigurojë një ekonomi të fortë, me rritje të qëndrueshme dhe të vlerësuar ndërkombëtarisht. Pasi kaluam krizat dhe stabilizuam sistemet bazë të ligjshmërisë, konkurrueshmërisë dhe drejtësisë, Shqipëria, e drejtuar nga Partia Socialiste, do të hyjë në rrugën e modernizimit të ekonomisë prodhuese, turizmit, ekonomisë digjitale, bujqësisë, konektivitetit dhe energjisë.

Do të sigurojmë që rritja ekonomike e qëndrueshme të vijojë dhe efektet e saj të ndihen nga çdo qytetar i vendit.

Duke investuar në zhvillimin teknologjik do të nxisim ekonomi të fortë prodhuese, duke siguruar që kompanitë e suksesshme dhe ndërmarrjet e reja në vend të krijojnë një vlerë të shtuar në zinxhirin e prodhimit. Ndërmarrjet e manifakturës nuk do të jenë më të kufizuara në regjimin e përpunimit aktiv për *brand*-et ndërkombëtare, por do të kalojnë në nivelin tjetër, në ciklin e plotë të prodhimit duke promovuar markën **“Made in Albania”**, me të cilën do të konkurrojmë globalisht.

Shqipëria do të jetë një qendër rajonale për sipërmarrjet e reja në ekonominë digjitale, duke siguruar punë dinjitoze për të rinjtë e vendit.

Shqipëria do të kthehet në **zgjedhjen e parë si destinacion turistik** për rajonin dhe një destinacion me rëndësi për të gjithë Evropën. Duke gërshtuar turizmin e plazhit, detin dhe lundrimin, me ekoturizmin e maleve dhe natyrës, agroturizimin, trashëgiminë kulturore dhe

kulinarinë fantastike, “mikpritja e shqiptarit” do t'i rikthehet krenarisë sonë dhe do të jetë një burim kyç i ekonomisë dhe i punësimit.

Sot, **bujqësia** është shndërruar në një prej motorëve kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit. Shqipëria do të shtojë prodhimin, do të rrisë cilësinë dhe certifikimet standarde, duke u bërë një aktor gjithmonë e më i rëndësishëm i eksporteve bujqësore. Bujqësia, bashkë me investimet në infrastrukturën dhe shërbimet në fshat, do të sigurojë mundësinë për të ndërtuar një jetë me mirëqenie në fshatin shqiptar.

Investimet në **infrastrukturën rrugore**, që përmirësojnë lëvizjen e njerëzve dhe të mallrave, me standarde sigurie dhe impakt në zhvillimin ekonomik dhe turizmin, do të vijnë në mandatin e tretë, jo vetëm në përmirësim të akseve ekzistuese, por edhe në rrugë të reja.

Shqipëria do të ketë tashmë më shumë se një aeroport, me fokus te turizmi, por dhe te lëvizja me kosto më të ulët e qytetarëve shqiptarë.

Shqipëria do të ketë **porte** moderne, porte mallrash, porte hidrokarburesh, porte pasagjerësh dhe marina, të specializuara në shërbimet e tyre.

Portet dhe marina jahtesh moderne, të vendosura përgjatë gjithë vijës bregdetare, në shërbim të zhvillimit, si pjesë e ofertës më të mirë turistike të detit Mesdhe, do të jenë risia e mandatit të tretë për t'i garantuar turizmit përparësinë e shpallur që në programin e fushatës zgjedhore.

Shqipëria do të jetë një vend eksportues neto i energjisë elektrike në të gjithë rajonin; me një sistem energjetik shumë më të diversifikuar dhe një vend që reduktimin e rezervës së tij të energjisë hidrike, të rinovueshme përgjatë thatësirave, do ta kompensojë me energji të gjelbër, të prodhuar nga impiantet diellore dhe ato të erës.

Modernizimi i shërbimeve dhe i infrastrukturës digjitale përbën një instrument të patjetërsueshëm dhe të pazëvendësueshëm për të luftuar korrupsionin dhe për të rritur, në mënyrë të shpejtë, cilësinë e shërbimeve ndaj publikut, si dhe produktivitetin e sipërmarrjes. Për këtë arsye, ne jemi të angazhuar fort në drejtim të përmbushjes së ambicies sonë, që të gjitha shërbimet e mundshme të ofrohen *online* për qytetarët dhe sipërmarrjet.



FAMILJA

Një familje e fortë është një Shqipëri e fortë

Ne besojmë se shteti duhet t'i gjendet pranë çdo familjeje, që nga formimi, e në çdo hap kyç të zhvillimit të saj.

Aspirata legjitime e një çifti të ri, për të krijuar një familje e për të pasur një shtëpi, është arsyeja e fortë që t'i mbështesim në zgjerimin e familjes, me të posaçme, që fillon nga kujdesi ndaj nënës gjatë shtatzënisë të lindja, bonusi i bebes, kujdesi parësor e arsimit i fëmijëve.

Shoqëria e dijes është vizioni ynë për Shqipërinë 2030. Atdhedashuria, që ushqehet dhe rritet me brezat e rinj, në një sistem arsimor që i edukon, sfidon, frymëzon dhe brumos fëmijët me dashurinë për vendin, por edhe i përgatit ata për të qenë konkurrues me të ngjashmit e tyre në botë.

Ndërtimi i një sistemi arsimor të aksesueshëm dhe me infrastrukturë moderne, siç kemi filluar ta tregojmë, do të jetë një tjetër objektiv madhor i këtij mandati. Do të nxisim orientimin e të rinjve në shkenca, teknologji, inxhinieri dhe matematikë, fusha që garantojnë jo vetëm një të ardhme të sigurt për ta, por edhe zhvillimin dhe konkurrueshmërinë e vendit.

Ne duhet t'i përgatitim brezat e rinj për të qenë konkurrues në realitetin e ri global, ndaj do t'i aftësojmë në gjuhë të huaja, që në klasën e parë, në kodim, si dhe do të ndërkombëtarizojmë universitetet tona në bashkëpunim me universitete simotra.

Ne besojmë që **shëndeti** është një e drejtë universale për të gjithë dhe jo një privilegj i pakicës, ndaj do të vijojmë të synojmë një sistem shëndetësor universal, që i ofron çdo shqiptari shërbim dinjitoz, cilësor, të barabartë dhe falas.

Ne besojmë se mund të kemi një të ardhme më të mirë, duke treguar respektin tonë për ata që na kanë siguruar të tashmen, ndaj do të vijojmë mbështetjen për moshën e tretë me pensione pa cenuar reformën e arritur, me shërbime të posaçme dhe hapësira rekreative të shtuara.

Kemi hedhur themelet dhe duam të forcojmë modelin e një **Shqipërie solidare**, gjithëpërfshirëse, ku së bashku u gjendemi pranë njerëzve që kanë më shumë nevojë, të moshuarve, familjeve me ndihmë ekonomike dhe atyre me nevoja të veçanta.

SHQIPËRIA E FORTË

Një vend me dinjitet, që kujdeset për të gjithë shqiptarët, dhe një partner dinjitoz i aleatëve tanë

Shqipëria e vitit 2013 ishte një vend i pasigurt në sytë e investitorëve të huaj dhe të partnerëve ndërkombëtarë, me një imazh të rrënuar nga mungesa e shtetit të së drejtës, korrupsionit në çdo qelizë të sistemit të drejtësisë së kapur peng, që promovonte pandëshkueshmërinë dhe plaçkitjen e pronës, duke na lënë të fundit në rrugën e integritimit evropian.

Shqipëria sot është një vend tjetër, por ne jemi të vetëdijshëm se beteja jonë për të çrrënjësuar nga themelet korrupsionin, për të rilindur sistemin e kalbur të drejtësisë, për të përmirësuar imazhin e vendit në rajon dhe në botë është një betejë që vazhdon dhe **reforma e guximshme në drejtësi** do të na çojë jo vetëm aty ku mundemi, por dhe aty ku aspirojmë, për një Shqipëri më të fortë.

Sot, falë Reformës në Drejtësi dhe *Vetting*-ut, më shumë se gjysma e gjyqtarëve janë përjashtuar nga sistemi. Ne do të vijojmë me të njëjtën vendosmëri luftën tonë për një Shqipëri të së drejtës, me shkurtimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore për qytetarët.

Shqipëria është sot më pranë Bashkimit Evropian se asnjëherë. Finalizuar një reformë të vështirë, atë në drejtësi, finalizuar shumë reforma të tjera duke mundur që sot, Shqipëria të jetë një vend shumë më i mirë dhe më i sigurt për të jetuar.

Kemi vënë në rrugën e duhur **çështjen e pronës**, e cila do të ofrojë më shumë siguri për qytetarët e sipërmarrjet shqiptare, si dhe do të nxisë më tej investimet e huaja.

Kemi forcuar imazhin e Shqipërisë si një partner e zë dinjitoz në botë dhe, sot, vendi ynë është në lartësinë e duhur për të mbrojtur interesat e të gjithë shqiptarëve.

Evropa e Bashkuar është busulla jonë dhe familja natyrale së cilës i përkasim, por ku ende mungojmë. **Politika jonë e jashtme** bazohet mbi një parim të qartë strategjik, që është aleanca e patjetërsueshme strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian.



RIMËKËMBJA

Pandemia e COVID-19, që ndaloi jetën duke penguar progresin e zhvillimin normal, si dhe duke hedhur hije pasigurie për të ardhmen në të gjithë botën, vendin tonë e goditi menjëherë pas tërmetit shkatërrues të 26 nëntorit 2019, duke shumëfishuar sfidën, dhe më shumë se kurrë përgjegjësinë tonë.

Dy goditje njëra pas tjetrës, që askush tjetër, veç qeverisë së Partisë Socialiste, nuk do të kishte mundur t'i përballonte. Ne po e fitojmë ditë pas dite betejën për të dalë më të fortë prej tyre. Siç po dalin më të forta familjet që humbën shtëpinë; fëmijët e mësuesit që humbën shkollën, kopshtin, çerdhen dhe të gjitha komunitetet në lagjet e reja, që po rilindin më të sigurt dhe më të bukura mbi rrënojat e tërmetit në 11 bashki.

Rimëkëmbja do të mbetet prioriteti kryesor për punën tonë. Në vitin 2022, Shqipëria do të jetë jo vetëm e shëruar nga tërmeti e pandemia, por përmes Planit të Rimëkëmbjes, ne do të krijojmë më shumë vende të reja pune, duke mbështetur sektorët ekonomikë më të prekur, si: turizmi, bizneset e transporti, të cilat do të rikthehen në rrugën e duhur të rritjes e produktivitetit ekonomik.

RINDËRTIMI

Në fund të pranverës së vitit 2022 nuk do të ketë më asnjë gjurmë të tërmetit

Rindërtimi është sot programi më i madh urban, ekonomik e social, që garanton më shumë se veç rimëkëmbjen pas tërmetit. Çdo familje që humbi shtëpinë do të marrë një të re, falas, të ndërtuar më mirë, më fort, më bukur, me standarde ndërkombëtare, e po njëllot të gjitha shkollat, çerdhet, kopshtet dhe objektet publike. Sot e gjithë zona e dëmtuar është një kantiër ndërtimi, që ka krijuar punësim masiv dhe një impakt ekonomik të konsiderueshëm.

Vendosim mbi 60 miliardë lekë nga buxheti i shtetit në funksion të Programit të Rindërtimit për tre vjet. 100% e granteve të premtuara në Konferencën e Donatorëve, 300 milionë euro, janë aktive në mbi 30 projekte konkrete në strehim, arsim dhe infrastrukturë publike. Mbi 33 mijë e 400 familje kanë përfituar grante rikonstruksioni dhe rindërtimi në vlerën 12.7 miliardë lekë, krahas rikonstruksionit të ambienteve të përbashkëta në mbi 1100 pallate. 13 mijë e 325 qytetarë janë trajtuar me bonus qiraje, pagesa që do të vazhdojnë deri në rikthimin në banesat e reja. 27 shkolla kanë

përfunduar, ndërsa puna vijon çdo ditë në kantieret e reja të objekteve arsimore, pallateve dhe infrastrukturës publike në lagjet e reja, që do t'u shërbejë 500 mijë banorëve.

450 kompani kanë angazhuar mbi 24 mijë punëtorë në rreth 3100 kantiere ndërtimi, ku po marrin formë çdo ditë godinat e reja, të pakrahasueshme me ato që shkatërroi tërmeti.

Në fund të pranverës së vitit 2022 nuk do të ketë më asnjë gjurmë të tërmetit shkatërrues të 26 nëntorit 2019:

- 4500 banesa të reja individuale do të përfundojnë, duke strehuar të gjithë banorët që humbën shtëpitë e tyre;

- 13 mijë familjet, që po trajtohen aktualisht me bonus qiraje, do të vijojnë të marrin bonusin dhe përfitimet e tjera deri në ditën që do t'u dorëzohen çelësat e shtëpisë së re në dorë;

- 12 mijë apartamente në lagjet e reja do të jenë ndërtuar, duke strehuar të gjitha familjet që humbën apartamentet e tyre;

- 28 kantiere të reja të infrastrukturës publike do të kenë përfunduar deri në pranverën e vitit 2022;

- shkollat e reja po ngrihen shumë më të forta, shumë më moderne dhe të afta për t'u përgjigjur nevojave të kohës. Brenda pranverës 2022 përfundon rehabilitimi dhe ndërtimi i mbi 160 çerdheve, kopshteve, shkollave e konvikteve.

LUFTA ME PANDEMINË COVID-19

Efektet e pandemisë përgjatë një viti kanë lënë gjurmë të rëndësishme në jetën e përditshme të miliarda njerëzve në të gjithë botën, kanë sfiduar sistemet shëndetësore dhe shkencën e teknologjinë, dhe kanë ridimensionuar biznesin, shërbimet dhe punësimin.

Ne u kujdesëm që në krye të herës për menaxhimin e pandemisë, jo vetëm në aspektin e shëndetit, por edhe atë ekonomik, për të mos lënë vetëm mijëra familje shqiptare, të punësuar e të vetëpunësuar, të prekur drejtpërsëdrejti nga pandemia.

Me një paketë gjithëpërfshirëse prej 80 miliardë lekësh, mbështetja e dedikuar e qeverisë për menaxhimin e efekteve të pandemisë është sot e barabartë me rreth 5% të PBB-së.

Përmes pagave të luftës dhe instrumenteve të garancisë sovrane, mbështetëm gati gjysmën e të punësuarve në sektorin privat në mbi 83 700 biznese.



Dyfishuam ndihmën ekonomike në vitin 2020 dhe 2021, dyfishuam pagesën e papunësisë, garantuam rimbursimin e barnave të paketës për trajtimin e virusit, falëm kamatëvonesat e energjisë elektrike për mbi 210 mijë konsumatorë dhe riskeduluam deklaratimet e bizneseve për vitin 2021.

Falë mirëmenaxhimit dhe politikave të ndërmarra në qeveri, sot i kemi rifituar të gjitha vendet e punës që u humbën nga pandemia. Në dhjetor 2020 u numëruan mbi 688 mijë të punësuar nga 677,500 në të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe nga vetëm 478 mijë të tillë në dhjetor 2013.

- Vaksinimi i popullatës kritike, personat në moshë mbi 60 vjeç dhe ata me sëmundje bashkëshoqëruese do të ketë përfunduar brenda shtator 2021.

- Garantojmë vaksinimin për të gjithë popullsinë mbi 16 vjeç deri në shkurt 2022.

- Mbështesim sipërmarrjen në sektorët më produktivë të ekonomisë, për ringritjen edhe më të fortë të tyre pas pandemisë, duke dedikuar:

- 50 milionë euro për sipërmarrjet në sektorin e turizmit, në formën e instrumentit të garancisë;

- 5 milionë euro për sipërmarrjet në fushën e transportit;

- 50 milionë euro për sipërmarrjet në sektorin e manifakturës, si garanci për kreditim apo zgjatje të afatit të kredive ekzistuese.

NJË STRATEGJI E RE PËR SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

Si çdo krizë, edhe pandemia botërore e COVID-19, i solli botës një tragjedi të re, por në të njëjtën kohë edhe një mundësi për të parë të ardhmen në një dritë tjetër.

Shumë studime të publikuara sot mbi shkaqet, pasojat dhe efektivitetin e politikave të ndjekura nga vende të ndryshme në përgjigje të pandemisë, sugjerojnë së pari nevojën për një koordinim më të mirë të politikave sektoriale nacionale, me një qasje të orientuar nga shëndeti dhe, së dyti, një koordinim më të mirë për një përgjigje të unifikuar globale ndaj sfidave që dalin përtej kufijve nacionalë.

Pandemia gjeneroi efekte negative sa në aspektin shëndetësor, aq edhe në atë ekonomik dhe financiar, në edukim, transport, turizëm, mjedis, kohezionin social etj. Vlerësimet sugjerojnë se prodhimi global më 2020-ën ra me 3.3%, krahasuar

me 1% gjatë krizës financiare globale të vitit 2008, ndërsa disa prej vendeve më të goditura ishin ato me ekonomi të orientuara kah turizmi apo eksporti i të mirave.

Ndaj, politikat për rimëkëmbjen pas pandemisë do të duhet të ridisenjohen për të adresuar në të njëjtën kohë efektet dhe për të prodhuar impakt në shumë sektorë.

Shëndeti kërkon një zhvillim të qëndrueshëm, ndaj për t'iu përgjigjur sfidave të tilla në të ardhmen, ne do të përshtatim dhe zbatojmë mekanizmin *One Health*, si një politikë e re, inovative, e cila do të integrohet brenda një kuadri të gjerë e koherent politikash, përfshirë ato ekonomike, financiare, teknologjike, sociale, por edhe politikën e jashtme.

Strategjia *One Health* bazohet mbi parimin e “shëndetit në çdo politikë” dhe “zhvillimin e qëndrueshëm” dhe synon të krijojë strukturat dhe incentivat për të bashkërenduar masat dhe politikat në një sërë sektorësh, kryesisht atë të shëndetësisë, bujqësisë dhe mjedisit, në një strategji koherente ndërsektoriale zhvillimi, të koordinuar me organizatat ndërkombëtare, si WHO, FAO, OIE etj., ku shëndeti i qytetarëve nuk shihet më thjesht i lidhur me sistemin shëndetësor në vetvete, por edhe me impaktin e mjedisit, sigurinë ushqimore, cilësinë e jetës.

- Investojmë në ndërtimin e një sistemi shëndetësor kombëtar të fortë, rezistent dhe gjithëpërfshirës – duke rritur investimet në infrastrukturën shëndetësore, përmirësuar kapacitetet, duke ruajtur forcën e punës në shëndetësi dhe duke promovuar kujdesin social, njëlloj i rëndësishëm me atë shëndetësor.

- Aplikojmë qasjen *One Health* – si një qasje bashkëpunuese, ndërsektoriale dhe ndërdisiplinore, që zbatohet në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim arritjen e rezultateve optimale në shëndetësi, duke njohur lidhjen e rëndësishme mes shëndetit dhe mjedisit.

- Adresojmë pabarazinë mes kategorive të ndryshme sociale të shkakuar nga pandemia – ndjekim politika të dedikuara për shtresat më të prekura të popullsisë dhe mundësojmë rritjen e aksesit të tyre në kujdes shëndetësor e social.

- Ndërtojmë një sistem të dhënash që garanton informacion për “shpërndarjen” dhe aksesin në shëndetësi të popullatës, që mundëson një monitorim konstant për adresimin e pabarazive.



- Nxsisim inovacionin dhe rritjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit në shëndetësi.

- I japim përparësi integritit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe social, duke siguruar një kujdes të fokusuar te pacienti dhe duke ndërtuar një sistem të fortë të kujdesit primar.

- I japim përparësi parandalimit të sëmundjeve të transmetueshme dhe jo të transmetueshme.

MIRËQENIE PËR TË GJITHË

Në kushtet e krizave të thella ekonomike, si ajo që trashëguam në vitin 2013, shumë qeveri zgjedhin rrugën e vështirë të shkurtimit të shpenzimeve përmes uljes së pagave dhe pensione. Ne vendosëm një balancë mes nevojës për konsolidim fiskal dhe ruajtjes së mirëqenies së qytetarëve, duke hartuar një paketë të plotë reformash të vështira, por të domosdoshme, të cilat e shpërblyen ekonominë dhe qytetarët.

- Luftuam informalitetin, duke rritur të ardhurat në buxhet me 42%; ulëm borxhin publik dhe përmirësuar shërbimin e borxhit, duke rritur ndjeshëm raportin e lekëve të investuar me ata të marrë borxh.

- Rritëm të ardhurat në buxhetin e shtetit me 133 miliardë lekë më shumë më 2019–ën krahasuar me 2013–ën. Në vitin 2021 do të jenë 157 miliardë lekë më shumë se në vitin 2013.

- Vendosëm taksimin e ndershmë progresiv dhe bëmë të mundur, që: kush fiton më pak paguan më pak; në 8 vjet, vetëm përmes taksës progresive u kemi kthyer mbrapsht qytetarëve 960 milionë dollarë.

- Ulëm nivelin e papunësisë në rekordin historik të 11%; shtuam lehtësitë fiskale në sektorët kyç dhe zëruam taksat e biznesit të vogël.

- Rritëm të gjitha pagat e administratës publike dhe pagën minimale nga 200 mijë e rritëm në 300 mijë lekë.

Më 2006–2013, të ardhurat mesatare për frymë në vit ishin 4,030 dollarë, ndërsa ne, në vitet 2014–2020 i rritëm ato 4,717 dollarë. Në vitin 2021, e ardhura mesatare për frymë në vit parashikohet në 5,687 dollarë. Të ardhurat e disponueshme janë sot 25.7% më të larta se në vitin 2013.

Investuam 59 miliardë lekë në Programin e Rilindjes Urbane, jo vetëm për të rilindur qytetet, por edhe për t'u dhënë një hov të ri ekonomisë, punësimit, turizmit, vlerës së pronës dhe sipërmarrjeve të reja.

Në Vlorë, vlera e pronës është dyfishuar pas Programit të Rilindjes Urbane. Të ardhurat e bizneseve janë 40% më të larta, ndërsa kapacitetet akomoduese në strukturat e hotelierisë janë 4-fishuar.

Në Korçë, investimi 30 milionë euro i Rilindjes Urbane, gjeneron të paktën po aq milionë euro shtesë të ardhura në vit. Bashkia sot mbledh 4 herë më shumë të ardhura vendore se më parë, të cilat përkthehen në më shumë investime publike dhe shërbime për qytetarët. Numri i bujtinave dhe i strukturave të turizmit është dyfishuar.

Në qarkun Shkodër, numri i vizitorëve ka një rritje prej mesatarisht 30% në 4 vjetët e fundit. Numri i sipërmarrjeve të reja pas përfundimit të programit të Rilindjes Urbane u rrit me 42% në Shkodër, 30% në Pukë, 83% në Malësinë e Madhe.

Treguam vëmendje reale për herë të parë edhe për fshatin, duke investuar 200 milionë dollarë në rimëkëmbjen e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit.

Ne do të vijojmë të sigurojmë rritje e zhvillim ekonomik për më shumë të ardhura, një jetë dinjitoze e përfshirje në jetën ekonomike për të gjithë qytetarët, duke vënë theksin te bizneset e vogla, te familjet produktive, fshati dhe forca punëtore, që shtyn përpara zhvillimet pozitive të vendit.

Shënjestrat:

- rritja ekonomike do të jetë mesatarisht 4.5% në vit dhe do të mbështesë një rritje edhe më të madhe të pagave në nivel vendi;

- konsolidim i përshpejtuar fiskal, duke synuar borxh nën 60% në fund të mandatit;

- rrisim të ardhurat e disponueshme me 20% deri në fund të mandatit;

- rrisim pagën mesatare mujore bruto me 25% në mënyrë graduale deri në fund të mandatit.

- rrisim pagat e administratës publike.

TAKSA E NDERSHME PROGRESIVE

Në vitin 2013, taksa e sheshtë rëndonte mbi kurrrizin e familjeve me të ardhura të ulëta e të mesme, mbi biznesin e vogël familjar dhe mbi të vetëpunësuarit. Më të pasurit e shoqërisë ishin të favorizuar, biznesi i vogël paguante më shumë taksa se biznesi i madh.

Falë taksimit të ndershmë progresiv, 670 mijë të punësuar ose 97% e të punësuarve në Shqipëri, sot



paguajnë më pak. Qytetarët, që jetojnë me një pagë minimale deri në 30 mijë lekë, paguajnë zero taksa.

Një i punësuar me pagë mesatare 52.800 lekë/muaj, vetëm përmes taksës progresive kursen 27,786 lekë/vit ose rreth 52.6% të një page.

Një infermier me pagë mesatare 65 mijë lekë/muaj, përmes taksës progresive kursen 23,400 lekë/vit ose 36% të pagës.

Një mësues me pagë 75.5 mijë lekë/muaj, i kthehen mbrapsht 19,602 lekë/vit ose rreth 26% e pagës.

Në 8 vjet, vetëm përmes taksës progresive, iu kemi kursyer qytetarëve shqiptarë mesatarisht 12.5 miliardë lekë/vit.

105 mijë biznese të vogla, në të cilat janë punësuar 150 mijë shqiptarë sot paguajnë **ZERO tatim fitimi**, duke kursyer 200 milionë dollarë. Ndërsa 100 bizneset më të mëdha, falë taksës progresive sot paguajnë 460% më shumë taksa nga sa paguanin me taksën e sheshtë.

Çdo qytetar, që siguron më pak të ardhura, do të paguajë më pak edhe në Shqipërinë 2030. Por, kush fiton më shumë do të kontribuojë më shumë për mirëqenien e përbashkët. Nuk do të jenë kurrë më fermeri, punëtori apo mësuesi, ata që do të mbajnë një barrë më të madhe se bankieri apo biznesmeni i madh.

- Rrisim dyshtemenë për pagat e patatueshme nga 30 mijë në 40 mijë lekë në muaj. Me këtë masë, 435 mijë të punësuar, ose 63.8% e totalit të të punësuarve, paguajnë zero taksë.

- Mbështesim shtresën e mesme, duke rishikuar fashën e sipërme të taksimit progresiv. Tatimi 23% do të fillojë të aplikohet në pagat mbi 200 mijë lekë dhe, më tej, brenda afatit të deklaruar 250 mijë lekë, nga 150 mijë që është sot.

- Nga 1 janari 2023, rimbursimi i TVSH-së për bizneset do të jetë automatik.

- Shërbimet ndaj tatimpaguesve 100% digjitale. Inspektorët do të vizitojnë bizneset, atëherë kur të kenë nevojë për verifikime, por jo më shumë se një herë në vit.

RRITJA E PAGAVE

Në 8 vjetët e fundit, paga minimale, paga mesatare dhe paga e punonjësve të shtetit ka njohur rritjen reale më të madhe ndonjëherë.

Rikthyem **dinjitetin e mjekut**. Një mjek apo infermier në spital sot merr 63% më shumë se në vitin 2013. Një mjek në një qendër shëndetësore

paguhet 57% më shumë. Një infermier apo laborant në qendër shëndetësore paguhet 68% më shumë. Mjekët dhe infermierët në vijën e parë të luftës ndaj COVID-19 përfitojnë bonusin 1.000 euro mbi pagën në muaj, ndërsa stafi mbështetës, shumën 500 euro. Ata mjekë specialistë, që pranojnë transferimin në qendrat rajonale, përfitojnë bonusin 250 mijë lekë mbi pagën.

Rikthyem **dinjitetin e policit të shtetit**. Sot, një punonjës policie përfiton 46% më shumë.

Rikthyem **dinjitetin e mësuesit**. Një arsimtar, në arsimin parauniversitar, paguhet 32% më shumë. Nga 1 janari 2021 hyri në fuqi rritja më e madhe e pagave ndonjëherë për mjekun dhe mësuesin: 40% më shumë për mjekët dhe 15% më shumë për mësuesin.

Në këto 8 vjet, **paga minimale** u rrit me 50%, duke shkuar nga 22.000 lekë në muaj në 30.000 lekë në muaj. Ndërsa paga mesatare është rritur nga 58 mijë lekë në 72 mijë lekë.

Duke filluar nga korriku 2022, rrisim gradualisht dhe në mënyrë të përshkallëzuar pagat e administratës:

- rrisim pagat e mësuesve, mjekëve dhe infermierëve me 40% deri në fund të mandatit të tretë;

- rrisim pagat e punonjësve të administratës publike me 30% deri në fund të mandatit të tretë;

- rrisim pagën mesatare në administratë, nga 72 mijë lekë/muaj në 85 mijë lekë/muaj deri në fund të mandatit të tretë.

BIZNESI I VOGËL DHE FAMILJA PRODUKTIVE

Ne e njohim rolin e madh që luajnë bizneset familjare dhe biznesi i vogël në krijimin e punësimit dhe në aktivitetin ekonomik të vendit, prandaj në këto 8 vjet të qeverisjes sonë, mbështetja për ta ka qenë në themel të politikave tona fiskale dhe sociale.

Në vitin 2013, 100% e biznesit të vogël ka qenë subjekt i tatim-fitimit me 10%. Gjatë vitit 2006–2013, qeveria e kohës i ka marrë biznesit të vogël rreth 19 miliardë lekë, ndërkohë që gjatë 2014–2019, biznesi i vogël ka paguar vetëm 5.3 miliardë lekë ose më pak se 1/3 e 8 vjetëve të mëparshëm. Pra, i kemi lënë 13.7 miliardë lekë biznesit të vogël për të rritur aktivitetin, e për të shtuar punonjësit. Jo rastësisht **numri i bizneseve të vogla në këto vite është trefishuar**, ndërsa taksat janë reduktuar,



dhe sot janë zero. Në Shqipëri janë rreth 105 mijë biznese të vogla me 150 mijë të punësuar. Në fund të vitit 2020, këto biznese regjistruan 8,442 të punësuar më shumë krahasuar me dhjetorin 2019.

Biznesi i vogël do të vijojë të jetë i mbështetur me ZERO taksa, duke vendosur një vëmendje të veçantë te familja produktive. Ne do të mbështesim të gjitha ato familje që kanë ambicie të jenë produktive në ekonominë shqiptare, duke hapur një biznes familjar, që prodhon ose ofron shërbime. Ne do të sigurojmë suksesin dhe nxisim rritjen e produktivitetit të tyre, jo vetëm me mbështetje buxhetore e lehtësira fiskale, por dhe me masa që zgjerojnë aftësitë, njohuritë dhe adaptimin me metodat bashkëkohore të prodhimit e shërbimit.

- Biznesi i vogël me zero taksa.

- Viojmë të nxisim sipërmarrjet e të rinjve. Fondi i mbështetjes për sipërmarrjet e reja *start-up* do të 5-fishohet, duke arritur në 10 milionë euro.

- Do të përdorim instrumentin e amortizimit të përsheptuar gjatë vitit, për të nxitur investimet me pajisje të prodhuara brenda vendit, me vëmendje në pajisjet që kursejnë energji dhe që janë miqësore ndaj mjedisit, deri në kuotën 40%.

- Do të mbështesim emigrantët që të transferojnë në Shqipëri njohuritë e aftësitë e marra, përmes mbështetjes në formë granti në vlerën 5 mijë euro, për çdo biznes të nisur nga një emigrant i kthyer.

ZHVILLIMI I BUJQËSISË DHE I FSHATIT

Vëmendja e kthyer drejt fshatit me investimet më të mëdha të kryera ndonjëherë për lidhjen e tyre me qendrat urbane, rilindjen e trashëgimisë kulturore e historike, nxitjen dhe rritjen e agroturizmit, ka bërë që sot fshati të jetë një alternativë tërheqëse për të investuar e krijuar ekonomi.

Do të vijojmë të vendosur në politikat tona për të rritur cilësinë e jetës në fshat dhe për të diversifikuar hapësirat e mundësitë për aktivitet ekonomik.

Do të vijojmë të zbusim diferencën e standardeve të jetesës mes qytetit e fshatit, duke nxitur rritjen e ndërveprimeve ekonomike e sociale përmes vijimit të investimeve në ujësjellës-kanalizime, energji elektrike, shërbime shëndetësore e arsimore, infrastrukturë rrugore dhe në përmirësimin e teknologjisë e njohurive prodhuese.

- Do të vijojmë mbështetjen për rritjen e eksporteve nëpërmjet:

- orientimit të investimeve në shtimin e zinxhirit të vlerës në agropërpunim;

- lehtësirave në blerjen e makinerive dhe pajisjeve të agropërpunimit, duke u ofruar sipërmarrjeve ekzistuese të përdorin një amortizim të përsheptuar me dy herë;

- rritjes së aksesit në tregje të reja ndërkombëtare nëpërmjet informimit dhe lehtësimit të marrëveshjeve tregtare.

- Zhvillojmë fshatin drejt turizmit rural nëpërmjet:

- mekanizmave mbështetës për rritjen e numrit të bizneseve agroturistike dhe bujtinave;

- politikave nxitëse dedikuar emigrantëve, të rinjve dhe rritjes së përfshirjes së grave në sektor.

- Rrisim mbështetjen në bujqësi, blegtori dhe zhvillim rural:

- 70 milionë euro mbështetje të drejtpërdrejtë për fermerët nëpërmjet naftës pa akcizë dhe skemave kombëtare të mbështetjes;

- 146 milionë euro mbështetje nëpërmjet programit IPARD III.

- TVSH zero, për:

- makinat bujqësore si në import ashtu dhe brenda vendit;

- 27 zëra doganorë të peshkimit;

- rrjetat, anijet, pajisjet elektronike, frigoriferët, motorët e anijeve etj., në bordin e anijeve të peshkimit, të trajtuara si furnizime bordi;

- tarifa zero për regjistrimin dhe vaksinimin e detyruar të blegtorisë;

- blerja e gazoilit nga anijet e peshkimit me 0 akcizë, 0 taksë karburanti dhe 0 taksë karboni;

- tatim-fitimi 5% për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor.

MODERNIZIM PËR ZHVILLIM

Modernizimi për zhvillim që ne duam të ndërtojmë për Shqipërinë nuk lidhet vetëm me përparimin teknologjik apo shpërndarjen e informacionit, por lidhet me krijimin e sistemeve që krijojnë mundësi të reja dhe të barabarta, që rrisin shpejtësinë e ndërveprimit dhe cilësinë e prodhimit në fusha kyçe për rritjen ekonomike e çeljen e vendeve të reja të punës në bujqësi, infrastrukturë, turizëm apo manifakturë.



BIZNESI I MANIFAKTURËS, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE

Kur morëm në dorë drejtimin e vendit, punonjësit e manufakturave, një prej sektorëve që ofron punësim masiv në Republikën e Shqipërisë, ishin ndër punonjësit më të keqpaguar në nivel kombëtar, dhe shumica e tyre punonin të paregjistruar dhe pa kurrfarë mbrojtjeje. Rikthyem **dinjitetin e punonjësve në manufaktura**, duke rritur pagat minimale dhe mesatare përmes një sërë masash lehtësuese, si përjashtimi nga TVSH-ja e lëndës së parë apo materialeve shtesë që importohen për t'u rieksportuar.

Për qeverinë shqiptare, ndërmarrjet e manufakturës janë një partner i rëndësishëm në rritjen e punësimit dhe të ekonomisë. Në mandatin e ardhshëm, masat e marra do të nxisin diversifikimin e produkteve shqiptare, rritjen e eksporteve dhe përmirësimin e mëtejshëm të kushteve të punës dhe trajtimit financiar për të punësuarit në këtë sektor.

Me po të njëjtin vizion, qeveria ka mbështetur gjatë dy mandateve të para bizneset në fushën e **teknologjisë së informacionit**, duke zbatuar lehtësi fiskale, me qëllim nxitjen, zhvillimin dhe konsolidimin e sipërmarrjeve private në këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë së të ardhmes.

- Krijojmë instrumentin e garancisë prej 50 milionë eurosh për manufakturën në rastet e ndryshimit të porosive, për përballimin e kostove të ndërrimit dhe kalimit në linja prodhimi të reja.

- Do të krijojmë programet “Inovacion dhe ekselencë në manufakturë” dhe “Inovacion dhe ekselencë në IT” për trajnime në inovacion, disenjim, marketing, kërkim dhe zhvillim nëpërmjet mbulimit të kostove të trajnimit 100%. Kostot do të rimbursohen 50% direkt dhe 50% si dyfish i tatimit të zbritshëm ndaj shoqërive ku është i punësuar përfituesi.

- Tatimi fitimi vetëm 5% për sipërmarrjet në IT.

- Krijojmë instrumentin e garancisë për kreditim në IT prej 50 milionë eurosh.

INFRASTRUKTURA

Portat e ajrit janë një tjetër mundësi për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendit në përgjithësi dhe turizmit në veçanti. Me të njëjtin ritëm si në transportin detar edhe në atë ajror vijon implementimi i strategjisë për krijimin e një rrjeti

aeroportesh që do të mbulojë operate të brendshme, rajonale dhe ndërkontinentale; për t'i dhënë turizmit shqiptar nxitjen e nevojshme për t'u shndërruar në një shtyllë ekonomike të vendit, për të krijuar vende pune për mijëra qytetarë shqiptarë, dhe për t'u dhënë komuniteteve lokale një bum ekonomik të jashtëzakonshëm.

Objekti i strategjik i qeverisë shqiptare për zhvillimin e transportit detar ka në fokus ridimensionimin e infrastrukturës portuale dhe të transportit detar përmes zgjerimit të zonave portuale, komplementimit me zona të zhvillimit ekonomik, zhvillimit dhe specializimit të porteve ekzistuese, sipas sektorëve ekonomikë primarë ku operojnë, si dhe përmes shtimit të strukturave të specializuara për akomodimin dhe ofrimin e shërbimeve për mjetet lundruese turistike, të luksit, të transportit të mallrave apo të pasagjerëve.

Në sektorin e infrastrukturës rrugore, vijon implementimi i strategjisë për ndërtimin e një rrjeti efikas dhe eficient të transportit rrugor të disponueshëm dhe të aksesueshëm nga të gjithë qytetarët; i menaxhuar nga autoritete të besueshme, transparente, me performancën e duhur dhe që siguron ndjeshëm mobilitetin, rritjen e cilësisë së jetës dhe rritjen ekonomike.

TRANSPORTI AJROR, RRUGOR, HEKURUDHOR DHE DETAR

- Nisim punimet për VIA (*Vlora International Airport*) brenda vitit 2021, që ky aeroport të jetë operacional më 2024-ën.

- Brenda vitit 2021 nënshkruajmë kontratën për ndërtimin e SIA (*Saranda International Airport*).

- Përfundojmë brenda vitit 2021 punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbrit.

- Aksi Kardhiq-Delvinë do të përfundojë tërësisht në pranverën e vitit të ardhshëm (maj 2022).

- Nisim brenda vitit punimet për **hekurudhën Tiranë–Rinas–Durrës**.

- Nisim në janar 2022 punën për transformimin e Portit aktual të Durrësit në një hapësirë moderne të kompletuar me një marinë jahtesh, infrastrukturë turistike dhe komplekse rezidenciale që do të pozicionojë Shqipërinë në hartën e turizmit elitare mesdhetar.



ENERGJIA

- Brenda marsit të vitit 2022 nënshkruajmë kontratën për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës, HEC-i më i madh në vend.

- Brenda qershorit 2022 nënshkruajmë kontratën për fillimin e punimeve për TEC Vlorë, projekt, i cili përfshin konvertimin e TEC Vlorë me LNG (gaz të lëngshëm natyror), të ndërtimi i një terminali rigazifikimi, e deri të shpërndarja në shkallë të vogël e LNG, duke shndërruar Vlorën në një HUB rajonal.

- Nisim punimet për ndërtimin e **Parkut Fotovoltaik të Karavastasë** prej 140 mw, më i madhi në Ballkan, në pranverën e vitit të ardhshëm (mars '22).

- Bursa Shqiptare e Energjisë do të bëhet krejtësisht operacionale në shkurt të vitit 2022.

TURIZMI DHE MJEDISI

Deri në vitin 2013, Shqipëria vuante imazhin e një destinacioni të pasigurt për turistët dhe tërhiqte vetëm të apasionuarit pas aventurës, si edhe bashkatdhetarët tanë në rajon e botë. Zhvillimet spontane në turizëm vuanin mungesën e infrastrukturës, zaptimin e hapësirave, mbeturinat, ndërtimet pa leje dhe mungesën e politikave mbështetëse për këtë sektor me potencial të jashtëzakonshëm për ekonominë e vendit.

Industria e turizmit ishte e përqendruar vetëm te bregdeti, ndërkohë që turizmi malor dhe qindra zona atraktive të vendit, së bashku me perlat e trashëgimisë sonë kulturore e historike ishin fshehur në pluhurin e braktisjes e të degradimit.

Degradimi mjedisor kishte mbërritur pothuaj në pikën e moskthimit, me mbetjet ilegale në çdo cep të Shqipërisë, me lumenjtë e shndërruar në landfille nga një anë e që u vidhej shtrati nga ana tjetër, me pyjet që pakësoheshin në mënyrë dramatike dhe me faunën nën kërcënimin serioz të zhdukjes.

Ne vendosëm kontroll mbi territorin, rikthyem te qytetarët hapësirat publike të zaptuara padrejtësisht dhe rilindëm qytetet nga Veriu në Jug, duke i transformuar në hapësira urbane Evropiane plot frymëmarrje për banorët dhe vizitorët turistë.

Vendosëm moratoriumin për prerjen e pyjeve e gjetinë, si dhe mbollëm 20 milionë pemë.

Përrjashtuam nga tatimi mbi fitimin për një periudhë 10-vjeçare hotelet me 4 dhe 5 yje; reduktuam TVSH-në në 6% për hotelet me 5 yje, si

dhe për shërbimet e akomodimit e të ushqimit brenda strukturave në sipërmarrjet në turizëm dhe në agroturizëm.

Nga 45 ditë që ishte në vitin 2013, arritëm në turizmin gjithëvjetor, si dhe trefishuam strukturat akomoduese nga 1074 që gjetëm, në 3264 sot. Hyrjet e shtetasve të huaj u dyfishuan nga 3.2 milionë në 6.4 milionë gjatë 2019-ës.

Për t'iu gjendur në kushtet e vështira të krijuara si rrjedhojë e pandemisë, qeveria ka mbështetur 10 mijë punonjës në 1214 biznese të sektorit të turizmit me një shumë prej 0.4 miliardë lekësh.

Nga më pak se 50 mijë punonjës në vitin 2013, sot sektori i turizmit numëron 60 mijë të punësuar direkt dhe 250 mijë të tjerë indirekt.

- Menaxhim i integruar i mbetjeve në tërësinë e territorit sipas masterplanit.

- Reduktim me synim zhdukjen e ambalazhit plastik njëpërdorimësh.

- Riorganizim i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, me ligj të ri të dedikuar menaxhimit të integruar të bregdetit, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me bashkitë bregdetare.

- Inkurajimi i *brand-eve* të mirënjohura ndërkombëtare për të investuar apo për të operuar në Shqipëri.

- Përfundimi i procesit të lëvizjes së mjeteve lundruese përmes platformës *online* të hyrje-daljeve.

- Promovimi i flamurit shqiptar në tregun ndërkombëtar, si destinacion *tax-free*.

- Riorganizim i Agjencisë Kombëtare të Turizmit në përgjigje të flukseve të pritshme turistike dhe të kërkesave në rritje të operatorëve turistikë.

KULTURA

- Vendosim në funksionim skemën kombëtare “Bonusi i rritjes”, një financim për restaurimin dhe kthimin e objekteve brenda qendrave historike, në modele të qëndrueshme biznesi, që gjenerojnë të ardhura dhe punësim për komunitetin.

- Ndërtojmë parkun e artit, një hapësirë social-kulturore në zonën e ish-Kinostudios “Shqipëria e Re”, duke përfshirë edhe zonën përreth saj, ku parashikohet dhe ndërtimi i Muzeut të Filmit, i cili synon transformimin e AQSHF-së në një njësi bashkëkohore të ruajtjes dhe të promovimit të filmit shqiptar, sipas standardeve të kohës.



- Fillojmë punimet për ndërtimin e Muzeut Hebraik Shqiptar, si pjesë integrale e projektit të rivitalizimit të Qendrës Historike të Vlorës.

- Përfundojmë Projektin e Rijetëzimit të Amfiteatrit Durrës.

SHOQËRIA DIGJITALE

Modernizimi i shërbimeve dhe konsolidimi i infrastrukturës digjitale përbën një instrument të patjetërsueshëm dhe të pazëvendësueshëm për të luftuar korrupsionin dhe për të rritur në mënyrë të shpejtë cilësinë e shërbimeve ndaj publikut. Për këtë arsye, ne jemi të angazhuar fort në drejtim të përmbushjes së ambicies sonë, që të gjitha shërbimet e mundshme të ofrohen *online* për qytetarët.

Shqipëria është sot vendi me shërbimet më të avancuara digjitale në të gjithë rajonin. Nga 14 shërbime *online* më 2013-ën, tani kemi 1207 shërbime ose rreth 95 % të të gjitha shërbimeve publike. 5% e mbetur e shërbimeve publike nuk mund të digjitalizohen dhe të ofrohen elektronikisht, për shkak të nevojës për prezencë fizike të individit.

Numri i përdoruesve të regjistruar në portal është 36 herë më i lartë se më 2013-ën, duke numëruar 1,855,387 përdorues të regjistruar. Qytetarët dhe bizneset nuk mbledhin më dokumente e vërtetime pasi janë punonjësit e administratës publike ata që mbledhin të gjitha dokumentet shtetërore të shërbimeve.

Raportet e organizatave më prestigjioze në botë, nga OBK-ja, OECD-ja, Departamenti Amerikan i Shtetit dhe, së fundi, ai i BE-së, i japin Shqipërisë vlerësime shumë të larta në qeverisjen digjitale, si një tregues i rëndësishëm i mirëqeverisjes dhe i mirëqenies së qytetarëve të një vendi.

Shqipëria 2030 do të jetë një Shqipëri tërësisht e digjitalizuar në funksion të qytetarit, sipërmarrjes dhe gjeneratës së re. Përmirësojmë dhe modernizojmë sistemet elektronike në të gjithë sektorët, me synim automatizimin dhe lehtësimin e jetës së qytetarit dhe të biznesit, si dhe aktivitetit të administratës publike.

- Sigurojmë marrjen e përgjigjes *online* me nënshkrim ose vulë elektronike për të gjitha shërbimet në *e-Albania*, si dhe digjitalizojmë arkivat fizikë për të rritur numrin e shërbimeve që merren në kohë reale me vulë elektronike.

- Realizojmë platformën *e-Rezidenca* për mundësimin e investimeve të huaja pa nevojën e prezencës fizike të investitorëve, duke përdorur identitetin digjital dhe shërbimet elektronike në *e-Albania*.

- Zgjerojmë rrjetin qeveritar *GovNet* për të ulur koston e shërbimit të internetit për institucionet shtetërore dhe rritjen e sigurisë së të dhënave.

- Bëjmë të mundur njohjen e nënshkrimit dhe vulës elektronike me vendet e rajonit.

FAMILJA

Një familje e fortë është edhe një Shqipëri e fortë, ndaj dhe mbështetja e familjeve që në hapat fillestarë të krijimit të saj është investimi më i madh që ne mund të bëjmë, përfutimet e të cilit kanë impakt të jashtëzakonshëm te shoqëria dhe ekonomia e vendit.

Ne jemi e vetmja forcë që ka investuar dhe i ka mbështetur familjet e reja që nga programi i strehimit, bonusi për bebet, e deri tek investimet e jashtëzakonshme në ndërtimin dhe në ringritjen e infrastrukturës për kujdesin e edukimin e fëmijëve në kushte bashkëkohore.

Fëmijët janë arsyeja themelore pse politika duhet të ekzistojë, pse partitë duhet të ndeshen në betejën e vizioneve dhe të ideve për të nesërmen, pse kjo qeveri duhet të vazhdojë të kërkojë më shumë nga vetja sot e përgjithmonë, me të gjithë përkushtim e saj. Në vizionin tonë për Shqipërinë 2030, fëmijët e të rinjtë kanë vëmendje të posaçme që shkon përtej infrastrukturës së shërbimeve në kujdesin dhe rritjen e tyre, duke vendosur fokusin te politikat e reja për shëndet më të mirë, edukim më cilësor dhe hapësira alternative që nxisin formimin dhe talentet e tyre.

Ne angazhohemi të rrisim strehimin e familjeve të reja, nxisim punësimin rinor dhe të grave e vajzave, duke rritur njëkohësisht në sasi e cilësi të gjitha shërbimet e shtetit për familjet. Do të rrisim ndihmën ekonomike çdo vit. Do të rrisim pensionet dhe bonusin e fundvitit për pensionistët do ta kthejmë në politikë të përhershme.

STREHIMI

Në vitin 2016, ne miratuam për herë të parë Strategjinë e Strehimit Social dhe ndërmorem reformën legislative, e cila bëri të mundur zbatimin e programeve, që adresonin nevojat e grupeve më



në nevojë të vendit, duke krijuar e shtuar edhe inventarin e banesave sociale.

Kemi shumëfishuar fondet e vendosura në dispozicion të strehimit dhe në dy mandate kemi shpërndarë rreth 30 milionë dollarë për strehimin e 12.750 familjeve, nga të cilët, mbi 8 mijë familjeve të komuniteteve të varfra dhe të pafavorizuara.

Nga viti 2018 deri në vitin 2020 kemi shtuar inventarin e banesave sociale me 665 njësi banimi, ngritëm, gjithashtu, sistemin *online* të aplikimit për strehim, duke rritur transparencën e duke lehtësuar qytetarët në mbledhjen e dokumentacionit, i cili tashmë mblidhet nga vetë administrata e njërive vendore.

Ne e kemi në fokus të veçantë strehimin, si një instrument që fuqizon ekonomikisht familjet dhe nxit zhvillimin social, duke përmirësuar kushtet e jetesës për shtresat më në nevojë. Ne do të rrisim më tej mbështetjen për programet e strehimit social, duke adresuar siç duhet nevojën e familjeve të reja për strehim dhe duke u krijuar të rinjve më shumë mundësi e siguri në krijimin e familjes dhe ndërtimin e së ardhmes në vendin e tyre.

- Familjeve të reja do t'u ofrojmë 1 milion lekë mbështetje për pagesën fillestare dhe zbutjen e interesit për blerjen e shtëpisë.

- Programi i banesave sociale – në bashkitë e mëdha me prurje të lartë demografike, do të ndërtohen rreth 2000 mijë banesa në vit për familjet, të cilat nuk përfitojnë nga paketa e familjeve të reja, përmes një instrumenti të posaçëm të garancisë sovrane nga qeveria. Programi nis brenda vitit 2022 me një fond 100 milionë euro të Bankës Evropiane të Investimeve.

- Rrisim numrin e grave kryefamiljare, personave me aftësi të kufizuara, jetimëve dhe komunitetit rom e egjiptian si përfitues prioritarë të programit social për strehimin.

FËMIJËT

Falë politikave që aplikuam gjatë qeverisjes sonë, sot shteti shqiptar ofron një paketë të plotë që nga dita e parë e jetës deri në përfundim të studimeve të larta për fëmijën që lind. Çeku i bebeve dhe rrjeti i çerdheve dhe i kopshteve të reja në të gjithë vendin e bëjnë sot shumë më të lehtë rritjen e një fëmije.

Qendrat urbane të rilindura me hapësira plot frymëmarrje, që ia rikthyem familjeve e komunitetit me parqe, kënde lojërash e gjelbërim, ishin vetëm

një hap në drejtim të rritjes së cilësisë së jetës, që falë vizionit e angazhimit të Partisë Socialiste sot është një realitet i prekshëm në çdo cep të Shqipërisë dhe me përfitues kryesorë prindërit, fëmijët e gjyshërit.

Vijua me transformimin e çerdheve, kopshteve e shkollave në institucione me hapësira dinjitoze për kujdesin, rritjen dhe edukimin e fëmijëve tanë, duke e zgjeruar funksionin e tyre e duke i kthyer në qendra komunitare, që u shërbejnë familjeve e banorëve përreth.

250 mijë fëmijë të klasave I–VII përfitojnë tekste falas, të hartuara në bashkëpunim me *Oxford*, *Cambridge* dhe *Pearson*. Fëmijët e 17 kategorive në nevojë apo të kategorive të caktuara sociale i përfitojnë tekstet falas për të gjithë ciklin parashkollor.

Partia Socialiste dhe qeveria e saj angazhohet me një ofertë të re për fëmijët e këtij vendi që siguron një shëndet më të mirë, kujdes dhe edukim cilësor, që i stimulon dhe i aftëson për një të ardhme më të sigurt. Vlerë e shtuar do të jenë programet e dedikuara për edukimin kulturor jashtëshkollor të tyre.

- Me fokus kujdesin për nënat e reja dhe të porsalindurit, vijojmë investimet në rrjetin e materniteteve dhe brenda vitit 2022, dy spitalet universitare të obstetrisë-gjinekologjisë do të kenë shërbime të reja diagnostikuese dhe trajtuese me infrastrukturë moderne.

- Financojmë paketën e fertilitetit falas, duke filluar nga viti 2022.

- Ofrojmë 10 mijë lekë/muaj për shpenzimet e çerdes/kopshtit për familjet me të ardhura deri në 100 mijë lekë/muaj.

- Krijojmë dy programe të dedikuara falas për kujdesin e syve dhe atë oral, për të gjithë fëmijët e moshës 6–15 vjeç.

- Fillojmë punën për ndërtimin e Qendrës Kombëtare për Fëmijë brenda qershorit 2022. Kjo qendër me sipërfaqe rreth 4500 m², pranë Liqenit Artificial të Tiranës, do të jetë një pol kulturor multifunksional, dedikuar fëmijëve si pjesë e *Tirana Park Extension*.

ARSIMI

Më 2020-ën arsimi shqiptar numëroi 263 shkolla të reja apo të rinovuara plotësisht, ku studiojnë 114 mijë nxënës, falë 130 milionë dollarë të investuara në infrastrukturën arsimore.



Në vitin 2021 vijon rikonstruktimi i 120 shkollave të reja, ku studiojnë 40 mijë nxënës më shumë.

Arsimi profesional, një formë arsimi e përbuzur dhe e neglizhuar për shumë kohë, ka qenë një ndër përparësitë absolute të qeverisë në vitet 2013–2021. Si rrjedhojë e 3-fishimit të buxhetit, sot kemi një rrjet të mirëfilltë shkollash moderne profesionale në të gjithë Shqipërinë, ku në total formohen në përputhje me nevojat e tregut 19 mijë të rinj.

Plani ynë për zhvillimin e sistemit arsimor do të pajisë studentët shqiptarë me dije dhe aftësi të konkurrueshme me bashkëmoshatarët e tyre në BE. Shkollat profesionale dhe universitetet do të përgatitin qytetarin e mirë dhe punonjësin e suksesshëm të vitit 2030.

Me investimet në laboratorë për kërkimin shkencor dhe me sigurimin e integritetit akademik dhe shkencor të universiteteve do të përmirësohet cilësia e produktit universitar, ndërsa diploma e secilit student do të mbartë vlerën që duhet ta ketë. Me investimet infrastrukturore në kampuset universitare do të përmirësohet eksperiencia studentore dhe do të inkurajohen të rinjtë të ndjekin ëndrrat e tyre në kampuset universitare shqiptare.

- Të mësuarit e gjuhës angleze që nga klasa e parë e arsimit bazë – me vitin shkollor 2021–2022 nis mësimi i gjuhës angleze, si lëndë e detyruar që nga klasa e parë e arsimit bazë.

- Klasat e profilizuara sportive – do të rritet numri i klasave të profilizuara sportive në mënyrë progresive në të gjithë vendin, duke filluar që nga viti shkollor 2021–2022 nga 223 në 423, duke shtuar edhe disiplina të reja sportive, si gjimnastikë, atletikë dhe tenis.

- Tekstet shkollore falas për të gjithë nxënësit e arsimit bazë – për vitin shkollor 2021–2022 janë përfshirë tashmë në skemën për tekstet shkollore në përdorim falas edhe nxënësit e klasës së tetë dhe të nëntë, në total 280 mijë nxënës të arsimit bazë dhe të kategorive të veçanta në arsimin e mesëm të lartë, duke lehtësuar ndjeshëm barrën financiare të familjeve.

- Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë – fillojmë punën për hapjen e filialeve të universiteteve më të mira ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe për programe studimi të përbashkëta dhe të dyfishta me to. MASR-ja do të mbështesë hapjen e

programeve në gjuhën angleze në të gjitha universitetet shqiptare.

KUJDESI PËR TË MOSHUARIT DHE QYTETARËT MË NË NEVOJË

Me reformën e ndërmarrë në vitin 2014 shpëtuam skemën e sigurimeve shoqërore nga kolapsi financiar, hoqëm tavanin për pensionin maksimal, duke rritur përfitimet e pensionistëve deri në 30%, si dhe shtuam 200 mijë kontribues më shumë në skemë.

Skema e re përfshiu për herë të parë të drejtën e pensionit social, duke dhënë përfundim për mijëra të moshuar pa histori kontributësh apo vjetërsie në punë. E gjithë kjo kategori nënash e gjyshërish do të ishin të braktisur pa asnjë të ardhur. Përmes indeksimit të pensioneve me inflacion të posaçëm, si dhe falë pagesës së fundvitit për të moshuarit, ne kemi rritur mesatarisht pensionet me 5% çdo vit.

Minatorët, naftëtarët, metalurgët, më në fund, kanë statusin e tyre të posaçëm që bën të mundur t'u njihen e t'u vlerësohen pas 30 vjetësh të gjitha mundimet e vështirësitë e profesionit. Kjo garantohej sot me një ligj të veçantë, që bën të mundur një pension më të lartë se shumica e pensioneve të profesioneve të tjera.

Buxheti për mbrojtjen sociale është sot më i lartë se kurrë më parë, duke arritur në 10.5% të PBB-së. Reformuam dy programe të ndihmës ekonomike dhe mbështetjes në pagesa të personave me aftësi të kufizuara. Trefishuam ndihmën ekonomike për familjet dhe individët në nevojë. Hoqëm kriteret abuzive dhe përjashtuese dhe ndërnuam një sistem transparent aplikimi, duke siguruar që ky program të siguronte gjithëpërfshirje.

Me këtë reformë u dhamë mundësi 10 mijë familjeve të reja, që me skemën e vjetër përjashtoheshin për kritere absurde, të përfitojnë për herë të parë ndihmë ekonomike në janar 2018.

67 mijë familje në nevojë përfitojnë shërbimet shëndetësore falas (mjeku i familjes falas, kontroll shëndetësor bazë falas, barnat me rimbursim etj.) përfitojnë, gjithashtu, kompensim për energjinë elektrike, kompensim monetar për shkollimin dhe librat falas, ndërsa personat me aftësi ndryshe përfitojnë përveç një mbështetje financiare më të lartë, edhe përparësi absolute në strehim, arsim apo punësim.



Gjatë periudhës së karantinës, 63,510 familje në të gjithë vendin përfituan 2-fishin e pagesës së ndihmës ekonomike.

Me vizionin tonë për Shqipërinë 2030, këto grupe mbështeten me vëmendje të veçantë përmes zgjerimit e rritjes financiare të programeve për mbrojtje dhe përfshirje sociale, duke iu përgjigjur nevojave të personave në moshën e tretë dhe komuniteteve në nevojë, si arsye thelbësore të besimit tonë të fortë të shoqëria solidare.

- Politika e bonusit të pensioneve të fundvitit do të kthehet në një politikë permanente të rritjes së pensioneve, përtej indeksimit, pa rrezikuar skemën dhe reformën e arritur. Kjo politikë do të garantojë një rritje të vazhdueshme vjetore prej mbi 5% për çdo pensionist.

- Zgjerohet skemën e mbulimit të familjeve dhe të individëve në nevojë, si dhe rrisim aksesin ndaj punësimit, duke përmirësuar lidhjen me skemat e punësimit, me shërbime të integruara për të arritur riintegrimin social të tyre në jetën shoqërore.

- Zgjerohet mbulimin e familjeve të varfra me skemën e ndihmës ekonomike, me përparësi familjet e komunitetit rom dhe atij egjiptian, me 10% në vit.

- Rrisim me 10% përfshirjen e grave kryefamiljare në skemën e ndihmës ekonomike.

- Nëpërmjet Fondit Social do të zgjerohet rrjeti i qendrave dhe i shërbimeve të reja në territor për fëmijët, gratë dhe të moshuarit në nevojë, në të gjitha bashkitë e vendit, si dhe do të mbështetet krijimi i 11 ndërmarrjeve sociale, me qëllim mbështetjen e grave dhe vajzave.

SHQIPËRIA E SHËNDETSHME

Në vitin 2013, vetëm 43% e shpenzimeve në shëndetësi mbuloheshin nga financimi publik. E përmbysëm atë realitet, duke rritur me 77% buxhetin në shëndetësi përgjatë 8 vjetëve.

Mbulimi universal shëndetësor është objektivi ynë afatgjatë për të garantuar akses, cilësi dhe siguri në ofrimin e shërbimit shëndetësor. Politikat e ndërmarrja kanë shënjestruar grupet vulnerabël dhe të pasiguruarit, duke i garantuar shërbime shëndetësore falas ose me tarifa minimale.

600 mijë të pasiguruar, deri dje tërësisht të përjashtuar nga mbulimi shëndetësor përfitojnë falas kontrollin mjekësor bazë, vizitat te mjeku i familjes dhe barnat e rimbursueshme.

Për herë të parë financuam një Program Kontrolli Mjekësor Bazë Falas për grup-moshat 35–70 vjeç, nga i cili përfitojnë 475 mijë persona çdo vit.

Nga programet e vaksinimit të fëmijëve dhe të grupeve të riskut kanë përfituar më shumë se 500 mijë fëmijë e të rritur.

U kursuem buxheteve familjare më shumë se 80 milionë dollarë në vit, nëpërmjet reformës së uljes së çmimit të barnave, heqjes së tarifave për shërbime dhe paketave shëndetësore të financuara në spitale publike dhe jopublike.

“Kantieri i shëndetësisë” vijon të përmirësojë infrastrukturën e sistemit shëndetësor. Ne e mbajmë premtimin e dhënë, për rindërtimin e 300 qendrave shëndetësore në të gjithë vendin, përmirësimin e infrastrukturës dhe fuqizimin me aparatura dhe pajisje mjekësore të spitaleve universitare dhe spitaleve rajonale.

U rikthyem dinjitetin mjekëve dhe infermierëve, duke u siguruar kushte më të mira pune, si dhe punësim mbi bazë merite të 1250 mjekëve dhe 3500 infermierëve. Rritëm pagat e personelit mjekësor me 57%. Paga mesatare bruto e një mjeku sot është 1100 dollarë. Paga mesatare e një infermieri sot është 650 dollarë. Ne i dhamë fund absurdit të ndalimit të specializimeve dhe që nga momenti i rihapjes janë mbi 1700 specializime të reja, duke përmbytur kërkesën e spitaleve për burime njerëzore me mjekë specializantë, në çdo qytet të Shqipërisë.

Vendosëm për herë të parë skemën e incentivave financiare me bonusin 2.5 milionë lekë mbi pagë, për mjekët që punojnë larg vendbanimit, për të forcuar kapacitetet dhe cilësinë e shërbimit në spitalet tona rajonale.

Ngritja e Shërbimit Kombëtar të Urgjencës Mjekësore dhe investimi në flotën e autoambulancave të reja, vendosi një standard bashkëkohor, duke reduktuar me dy herë kohën mesatare të mbërritjes së urgjencës në rang vendi.

Ne do të vijojmë të mbështesim një qasje të integruar të funksionimit të sistemit shëndetësor publik në të gjitha nivelet e sistemit, duke vendosur në qendër shëndetin e qytetarëve, si i vetmi mekanizëm funksional, që garanton shërbim shëndetësor cilësor, të aksesueshëm dhe të sigurt për grupet vulnerabël, të moshuarit, fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe, mbi të gjitha,



që garanton dhe zhvendos fokusin nga sëmundshmëria te shëndeti i popullatës.

Synimi ynë është që çdo qytetar shqiptar, pavarësisht statusit social-ekonomik, të ketë garancinë e plotë se në sistemin shëndetësor publik do të marrë shërbime me standardet më të mira në çdo etapë të jetës, në shëndet e në sëmundje, që prej lindjes e deri në pleqëri. Ne duam që shëndetësia shqiptare të bazohet në vlerat e solidaritetit dhe të barazisë për të garantuar që askush të mos mbetet pas.

Programi i Transformimit të Shëndetësisë 2030 do të prekë të gjitha hallkat e sistemit shëndetësor dhe **mbulimi shëndetësor universal** do mbetet objektivi ynë afatgjatë.

- Fillojmë pilotimin e modelit të ri të autonomisë spitalore në Spitalin e Ri në Fier brenda vitit 2022, për të vijuar me përkallëzimin në spitalet e tjera, me qëllim përmirësimin e sistemit të administrimit të spitaleve publike, sipas një sistemi që shpërblen mbi bazën e performancës dhe eliminon çdo abuzim dhe papërgjegjshmëri në kurriz të qytetarëve.

- Duke investuar në infrastrukturë e teknologji, brenda vitit 2025 do të kemi katër pole spitalore, që do të bëhen qendra reference diagnostikuese dhe trajtuese në katërta rajonet.

- Do të vendosim në funksionim 10 qendra model të mjekësisë familjare, me shërbime të integruara socioshëndetësore, me fokus problemet e shëndetit mendor, shërbimet për fëmijët dhe të rinjtë dhe kujdesin paliativ, brenda 2024-ës.

- Do të ndërtojmë Programin Kombëtar të Mjekësisë së Specializuar të Lëvizshme, me qëllim që qytetarët në zonat më të thella të vendit të kenë akses periodik në shërbimin shëndetësor.

SHQIPËRIA E FORTË

Shqipëria sot gëzon një reputacion të spikatur ndërkombëtar dhe jep kontribut të mirënjohur e të vlerësuar në luftën kundër terrorizmit në ruajtjen e sigurisë globale.

Nga një vend ku aspirata 25-vjeçare e shqiptarëve për drejtësi kishte kaluar kufijtë, duke u kthyer në shqetësim ndërkombëtar, sot Shqipëria është vendi me reformën më radikale të sistemit të drejtësisë, reformë e vlerësuar dhe mbështetur ndërkombëtarisht. E ndërtuar në arkitekturën e saj në bashkëpunim me aleatët tanë strategjikë,

reforma bëri të mundur pastrimin e mezi pritur të sistemit, dhe sot po shihen frytet e saj.

Deri në vitin 2013 vendi ishte zhytur në krim dhe pandëshkueshmëri, teksa vuante reputacionin e zymtë të trafikeve të drogës e të qenieve njerëzore. Shqipëria sot ka dalë nga lista e zezë e vendeve të origjinës së lëndëve narkotike dhe e vendeve të përfshira në hartën e trafikimit të qenieve njerëzore, ndërsa punën e saj në luftën e vendosur kundër kriminalitetit dhe rritjen e sigurisë për qytetarët e kryen në bashkëpunim të ngushtë me aleatët ndërkombëtarë.

Deri në vitin 2013, diplomacia shqiptare nuk kishte zë e nuk mbronte dot interesat e shqiptarëve, duke i lënë ata të braktisur në çdo vend të botës ku gjendeshin. Sot interesat e të gjithë shqiptarëve janë në qendër të diplomacisë tonë, duke përmbushur njëkohësisht edhe funksionin e përmirësimit të imazhit të vendit.

SHQIPËRIA E SË DREJTËS

Reforma në Drejtësi, një reformë historike e ideuar, e hartuar dhe e mbështetur nga qeveria, është një hap kyç në ndërtimin e një Shqipërie të fortë. Një Shqipëri, e cila rritet vazhdimisht ekonomikisht, e cila thëllon çdo ditë e më shumë shkëputjen nga korrupsioni e paligjshmëria, ku investimi vendës e i huaj është i sigurt e në pronë të sigurt, arrihet vetëm përmes ruajtjes, përfundimit dhe konsolidimit të Reformës në Drejtësi.

Procesi i *Vetting*-ut vijon të japë rezultate të prekshme për pastrimin e mëtejshëm të sistemit nga gjyqtarë e prokurorë, të cilët kanë nëpërkëmbur ndër vite dinjitetin e drejtësisë shqiptare. 55% e gjyqtarëve dhe e prokurorëve të verifikuar tashmë ose janë shkarkuar nga detyra ose kanë dhënë dorëheqjen.

Reforma në Drejtësi është ende një luftë për t'u fituar dhe betejat tona për suksesin e saj, për Shqipërinë e së drejtës, do të vijnë si garancia për të ardhmen, për Shqipërinë 2030, me një sistem imun të drejtësisë dhe të shkëputur totalisht nga padrejtësia e pandëshkueshmëria që trashëguam.

Shënjestrat:

- rrisim numrin e magjistratëve në Shkollën e Magjistraturës;

- rrisim aksesin e qytetarëve nëpërmjet digjitalizimit të sistemit të drejtësisë përmes krijimit dhe vendosjes në operim të platformës “Drejtësia ime”;



- hartojmë dhe miratojmë ligjin e arbitrazhit tregtar dhe të mekanizmave të tjerë të drejtësisë alternative;

- hartojmë Kodin e ri Penal për të ashpërsuar goditjen ndaj kriminalitetit dhe të pandëshkueshmërisë.

- Zgjerojmë dhe fuqizojmë rrjetin e koordinatorëve kundër korrupsionit.

SIGURIA E PRONËS

Trashëguam një kaos ligjor, me 16 ligje, që lidheshin drejtpërsëdrejti me problemet e pronësisë dhe që në shumë raste kundërshtonin njëri-tjetrin. Kaosi, mungesa e titujve të pronësisë dhe pasiguria e së drejtës së pronësisë, patën sjellë frenimin e investimeve vendëse dhe të huaja në qytet dhe paralizim të zhvillimit bujqësor në fshat. Rreth 300.000 familje bujqësore që, edhe 20 vjet pas miratimit të ligjit 7501, nuk kishin ende certifikatën e pronësisë.

Në vitin 2013 Shqipëria ende përballej me dilemën që, pa zgjidhje të problemit të pronësisë, nuk ka integrim të vendit në Evropë.

Premtimi më i madh i PD-së, për qindra mijëra familje të shpërngulura, ishte gënjeshtër më e madhe që u katandis në vetëm 21.000 legalizime në 8 vjet qeverisjeje deri në vitin 2013.

Legalizimi falas i banesave është një prej betejave të fituara të qeverisjes sonë. 210.000 objekte të legalizuara janë dëshmia e padiskutueshme e kësaj.

Miratuam një ligj të ri për trajtimin e pronës në vitin 2015, me një skemë dhe faturë të qartë financiare për kompensim, ligj i cili kaloi edhe “provimin” e vështirë të Gjykatës së Strasburgut.

Miratuam ligjin e ri për Kadastrën në vitin 2018, që hodhi bazat për një regjistër të ri, të plotë, të saktë dhe të aksesueshëm të pronave në Shqipëri.

Digjitalizimi i shërbimeve të pronësisë bëri të mundur që 100% e aplikimeve nga ana e qytetarëve të kryhen *online* dhe 100% e shërbimeve të ofrohen *online*.

Sot, barrierat e sigurisë së pronës, si kusht për integrimin evropian ka rënë. Vlerësimet pozitive të raporteve të Bashkimit Evropian të dy vjetëve të fundit janë dëshmia më e qartë, që, në nivel ndërkombëtar, është krijuar besueshmëria për suksesin e zgjidhjes së problematikës së pronësisë në Shqipëri.

Reforma ligjore dhe institucionale e ndërmarrë përgjatë vitit 2020 është reforma më e madhe në fushën e pronës në Shqipëri. Sfidat tona të radhës për Shqipërinë 2030 është implementimi i saj.

- I japim fund procesit 30-vjeçar të ndërtimeve pa leje brenda vitit 2022, ku asnjë banesë shqiptare që mund të legalizohet nuk do të ketë mbetur pa u legalizuar.

- Digjitalizojmë të gjitha shërbimet për pronësinë dhe modernizojmë sistemet për shërbim në kohë reale për qytetarët.

- Përfundojmë procesin e regjistrimit fillestar të pasurive në të gjitha zonat kadastrale të bregdetit.

- Digjitalizojmë kadastrën, duke e kthyer shërbimin kadastror në shërbim të aksesueshëm me një klik nga qytetarët përmes *e-Albania*.

KONSOLIDOJMË IMAZHIN DHE ROLIN E SHQIPËRISË

Ne do të vazhdojmë të forcojmë imazhin e një Shqipërie të fortë rajonalisht dhe që konsiderohet partnere serioze globalisht. Politika jonë e jashtme bazohet mbi një parim të qartë strategjik dhe mbi aleancën e patjetërsueshme strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet e Bashkimit Evropian.

Politika jonë e jashtme do të vijojë të udhëhiqet nga parimet e parashikueshmërisë, qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë, duke pasur në qendër të misionit të saj mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtarë, parandalimin e konflikteve, kontributin për paqen, stabilitetin dhe forcimin e rendit demokratik në rajonin tonë e më gjerë.

Angazhimi ynë në NATO synon të përforcojë pozitën e Shqipërisë si një vend që kontribuon në strukturat e sigurisë kolektive në hapësirën euroatlantike dhe si një aleat që merr njësoj përgjegjësi në përballimin e sfidave komplekse, në funksion të ruajtjes dhe konsolidimit të arkitekturës së sigurisë evropiane dhe paqes kudo ku aleanca kontribuon.

Më 11 qershor 2021, Shqipëria u zgjodh anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për periudhën 2022–2023. Zgjedhja për herë të parë e Shqipërisë si anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit është rezultat i vlerësimit të qëndrueshmërisë dhe konstruktivitetit të politikës së jashtme të vendit tonë, si dhe fushatës lobuese të suksesshme më shumë se 10-vjeçare.



Shfrytëzimi sa më i mirë i kësaj mundësie, nëpërmjet lënies së gjurmëve pozitive gjatë shërbimit tonë në Këshillin e Sigurimit, mbetet sfida madhore për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë dhe për institucionet që do të bashkëpunojnë në këtë proces.

- Forcimi i perceptimit pozitiv, i parashikueshmërisë dhe i besueshmërisë së politikës së jashtme të Shqipërisë.

- Forcimi dhe intensifikimi i marrëdhënieve me vende dhe organizata partnere, nëpërmjet punës së përbashkët dhe të bashkërenduar për tema të posaçme.

- Vendosja e kontakteve me vende dhe organizata që nuk kanë qenë në vëmendjen e politikës sonë të jashtme, shfrytëzimi më tej i këtyre kontakteve në shërbim të arritjes së objektivave afatgjatë të politikës së jashtme të vendit tonë.

- Forcimi dhe faktorizimi sa më shumë të jetë e mundur i pozicionit të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

MBROJMË INTERESAT E GJITHË SHQIPTARËVE

Shqipëria ka qenë gjithmonë një faktor stabiliteti në Ballkanin Perëndimor, jo vetëm për shkak të orientimit tonë të qartë euroatlantik, por edhe sepse në të shkuarën Tirana zyrtare ka refuzuar të ngrejë zërin dhe atëherë kur duhet. Tentativa për të tjetërsuar kufijtë detarë, pa pyetur ekspertët apo gjykatën ndërkombëtare, furnizimi me karburant në kushtet e një embargoje ndërkombëtare ndaj një armiku të angazhuar ndaj shqiptarëve apo heshtja përballë shkeljes së të drejtave të bashkëatdhetarëve tanë në rajon janë kapituj të errët të së shkuarës sonë.

Këta kapituj të errët nuk kanë asgjë të përbashkët me të ardhmen e Shqipërisë që duam. Politika jonë e jashtme dhe sidomos ajo rajonale bazohet në parime të patjetërsueshme të respektit të ndërsjellë, por tirana zyrtare nuk është dhe nuk do të jetë më kurrë e heshtur atëherë kur të drejtat tona cenohen.

Krijimi i një hapësire të përbashkët mbarëshqiptare, në zemër të familjes së kombeve evropiane, në respekt të plotë me të drejtat e vendeve fqinje dhe në përputhje të plotë me sovranitetin e tyre apo me parimet e shëndosha ndërkombëtare, është një projekt afatgjatë i shtetit shqiptar.

Kosova është tashmë një realitet i pakthyeshëm gjeopolitik dhe njohja e saj e shpejtë do të shërbejë për t'u ndarë nga koha e dhunës etnike, që ka përndjekur Ballkanin për një shekull, duke hapur një epokë të re të bashkëpunimit në rajon. Avancimi i të drejtave të shqiptarëve në të gjithë rajonin, si dhe rritja e bashkëpunimit rajonal në përputhje me angazhimet e *Open Balkan* apo të procesit të Berlinit, përbën një prioritet konstant të politikës sonë të jashtme.

- Angazhohemi në përforsimin e bashkëpunimit rajonal përmes *Open Balkan* dhe paketës së ndërlidhjes dhe të investimeve të procesit të Berlinit.

- Llojshmëri më fuqimisht për njohjen e shpejtë të Kosovës nga të gjitha vendet e botës dhe për pranimin e saj si një vend me të drejta të plota në OKB.

- Takimi i përvitshëm i qeverive Shqipëri-Kosovë zgjerohet për të përfshirë në tryezë edhe pakicat shqiptare në të gjithë rajonin.

INTEGRIMI EVROPIAN

Më 2014-ën, Shqipëria mori statusin e vendit kandidat, pas përmbushjes së kushteve në 5 fusha kyçe: reforma në administratën publike, reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar dhe respektimi i të drejtave themelore. Vit pas viti kemi përparuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha prioritetet e vendosura nga BE-ja. Si rezultat i këtyre arritjeve, në mars 2020, Bashkimi Evropian mori vendimin për të hapur negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, hapi i fundit përpara integritimit me të drejta të plota.

Detyra e Shqipërisë është që në katërvjeçarin e ardhshëm të ecë edhe më shpejt, me qëllim që qytetarët shqiptarë të shohin një datë të qartë, se kur i gjithë ky proces mund të finalizohet me Shqipërinë si një vend anëtar i Bashkimit Evropian.

- Mbajtja e Konferencës së parë Ndërqeveritare për Integritimin në BE dhe ndjekja e rekomandimeve për çdo etapë.

- Çojmë përpara nismën Ballkani i Hapur – vijojmë punën për të ndjekur zbatimin e tre marrëveshjeve të lidhura në takimin e datës 29 korrik 2021 midis Kryeministrit Rama, Kryeministrit Zaev dhe Presidentit Vuçiq, por edhe për të eksploruar mundësi të reja bashkëpunimi mes tre vendeve pjesëmarrëse.



SHQIPËRIA E SIGURT

Ajo që trashëguam ishte një polici, e cila arrinte të mbulonte vetëm 55% të territorit. Një polici me 70% të mjeteve të amortizuara dhe shumicën dërrmuese të efektivëve jashtë normave fizike dhe pa arsim të lartë. Trashëguam një polici që ishte një armë e korruptuar, e vjetruar, një polici që u përkiste vetëm burrave, klaneve dhe që më shumë se sa të luftonte krimin, flirtonte me të. Për të gjitha këto arsye, Policia e Shtetit ishte institucioni më i përbuzur, më pak i vlerësuar nga shqiptarët në të gjitha sondazhet e kryera.

Në harkun e pak vjetëve, Policia e Shtetit është shndërruar në institucionin që gëzon besimin më të lartë të publikut. Çfarë ka ndodhur? Sot, Policia e Shtetit kontrollon 100% të territorit, nga Tirana deri në fshatin më të largët. Sot, Policia e Shtetit është një armë moderne, me një flotë automjete plotësisht moderne, të cilave nuk u mbaron karburanti në ndjekje të keqbërësit, si dhe më efektivë të mirëkualifikuar dhe me arsim të lartë.

Rrjedhimisht, Shqipëria regjistron 2.5 herë më pak vrasje në vit. Janë përsëri shumë, por shumë më pak nga më përpara. Shqipëria sot regjistron dy herë më pak aksidente fatale. Janë përsëri shumë për Shqipërinë që Duam, por shumë më pak nga më parë. Shqipëria regjistron shumë më pak plagosje, grabitje me pasojë vdekjen, vjedhje të banesave, vjedhje të automjeteve, përdhunime apo krime në familje. Janë përsëri shumë për Shqipërinë që Duam, por ndryshimi është epokal.

Policia e Shtetit është ajo që në dy vjetët e fundit ka shkatërruar 30 grupe të krimit të organizuar dhe që ka vendosur në pranga 103 anëtarë të këtyre grupeve. Që, gjithashtu, nga më pak se një milion euro asete kriminale të konfiskuara më 2013-ën, sot heq nga duart e krimit dhjetëra miliona euro në vit. Më 2025-ën, me përfundimin e *Vetting*-ut në Policinë e Shtetit, objektivi ynë madhor është ai i një Shqipërie pa grupe kriminale, pa të fortë dhe banditë, një vend që për nga siguria, të renditet në mesataren e shteteve të BE-së.

- Ashpërsojmë betejën në luftën kundër krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti, në hetimin dhe në ndjekjen e aseteve dhe të pasurive të paligjshme të lidhura me krimin, duke rritur kapacitetet e strukturave dhe duke filluar punën brenda shtatorit 2021, për miratimin e Kodit të ri Penal.

- Sigurojmë kontrollin e plotë të territorit, veçanërisht ndaj ndërtimeve pa leje *nëpërmjet përdorimit të teknologjisë* dhe të investimeve të konsiderueshme në sistemet inteligjente bashkëkohore për monitorimin e veprimtarive të kundërligjshme e për sinjalizimin e rrezikut.

- Hartojmë ligjin që siguron dhe zgjeron aksesin e Policisë së Shtetit në regjistrat e llogarive bankare, në regjistrin e pronarëve përfitues, të pasurive të paluajtshme, noterëve, transaksioneve të dyshimta, si dhe në databazat e tatimeve dhe të doganave.

- *Rrisim sigurinë rrugore*, duke filluar punën për ndryshimet në Kodin Rrugor dhe për rritjen e investimeve në sistemet e monitorimit të trafikut dhe digjitalizimin e proceseve që kanë të bëjnë me përdoruesit e automjeteve dhe me sjelljen e tyre.

“Qeverisja më e mirë është ajo që na orienton të udhëheqim vetveten”, thotë Gëte.

Prandaj parimi aq i rëndësishëm për Partinë Socialiste, që në mandatin e dytë të bashkëqeverisjes do të vijojë të jetë bosht i mandatit të tretë, në formë më të strukturuar, ku partneriteti me çdo shqiptar, ku zëri i grave dhe i burrave, i të rinjve dhe i të moshuarve do të jetë bashkudhëtar i skuadrës qeverisëse, si garanci e transparencës, por edhe e matjes së rregullt të performancës së Qeverisë.

#Gati për Shqipërinë

VENDIM

Nr. 506, datë 17.9.2021

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM
TË TATIMEVE**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Delina Ibrahimaj të lirohet nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë